

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCIME

MBLEDHJE BORDI

Gjatë muajit maj, Enti Rregullator i Energjisë ka filluar procedurat e licencimit për subjektet e mëposhtme:

1. Shoqëria "EU GREEN ENERGY" shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 20MW.
2. Shoqëria "NOVA SOLAR SYSTEM" shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.
3. Shoqëria "PROINFINIT CONSULTING" shpk, në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike.
4. Shoqëria "SOLE 24 DOOEL Shkup – Dega në Shqipëri", Degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike.
5. Shoqëria "ReNRGY Trading Group" shpk, për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

KËTË MUAJ, BORDI I ERE-S KA ZHVILLUAR GJASHTË MBLEDHJE, TË CILAT KANË REZULTUAR NË 26 VENDIMMARRJE, NDËR TË CILAT, LICENCIMI I NJË SUBJEKTI NË PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRAL FOTOVOLTAIK, SI DHE MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN PRILL 2023 PREJ 16.85 LEKË/KWH PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV, POR DHE VENDIME MBI ÇËSHTJE TË BRENDSHME TË ORGANIZIMIT TË INSTITUCIONIT.

PJESË E AXHENDËS MUJORE KANË QËNË DHE SEANCAT DËGJIMORE QË LIDHEN ME TRAJTIMIN E ANKESAVE TË KONSUMATORËVE POR JO VETËM. PËR T'U AZHORNUAR NË MËNYRË MË TË DETAJUAR MBI VENDIMET E MARRA NGA ERE, REGJISTRIN E ANKESAVE, REGJISTRIN E LICENCIMEVE, TRANSPARENCËN APO INFORMACIONE TË TJERA, SHFLETONI FAQJEN TONË ZYRTARE WWW.ERE.GOV.AL.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIME

NJOFTIME

Gjithashtu, ndër vendimarrjet me rëndësi të marra gjatë këtij muaji vlen të përmendim:

- Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar prej prodhuesve ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike.
- Pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës impiantin fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, Hec "Vau i Dejës", të shoqërisë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)", për periudhën 13.05.2022 – 31.12.2022, për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 4,203 MWh.
- Disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin e matësave të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 164/2016", në vazhdim të procesit të nisur me Vendimin Nr. 70 Datë 13.03.2023, të Bordit të ERE. Kjo kontratë në objekt ka realizimin e shërbimeve në përputhje me Nenin 77 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", verifikimin fillestar të saktësisë dhe bashkëvulosjen e morseterisë të matësave të energjisë elektrike, përpara vënies në përdorim nëpërmjet metodës së kampionit në bazë të përzgjedhjes rastësore, pranë laboratorit të personit juridik të autorizuar ose në terren; si dhe verifikimin e saktësisë dhe të matësave të energjisë elektrike, pranë laboratorit të personit juridik të autorizuar ose në terren, me kërkesë të e operatorit të rrjetit, ankesë të klientit apo për verifikime periodike. Për sa i përket ndryshimeve të bëra në këtë kontratë, mund ti shfletoni duke klikuar [këtu](#).



Forumi Rregullator Evropian i Gazit 18 MAJ 2023

Z. Maksim Shuli, Komisioner në Entin Rregullator të Energjisë, së bashku me Drejtorin e Drejtorisë së Gazit Natyror, z. Gerti Bitri, morën pjesë në në takimin e tridhjetë e shtatë të Forumit Rregullator Evropian të Gazit. Në këtë takim, u diskutua ndër të tjera mbi zbatimin dhe sfidat e ardhshme të Kodeve të rrjetit të gazit, të cilët kanë një rol thelbësor në sigurimin e funksionimit të duhur të tregut evropian të gazit; rritjen e tregut të hidrogjenit në BE; dekarbonizimin e sistemit të gazit natyror; cilësinë e këtij të fundit në tranzicionin e energjisë si dhe mbi sesionin LNG. Gjatë takimit, Forumi cilësoi disa nga progreset, por dhe sfidat që vendet anëtare do të kenë në vazhdimësi për të cuar përpara procese të ndryshme dhe të nevojshme në tranzicionin e energjisë që kërkohet për të përmbushur objektivat e BE.

Në këtë forum pjesmarrës ishin autoritetet rregullatore kombëtare, qeveritë kombëtare të BE-së, Komisioni Evropian, operatorët e sistemit të transmetimit të gazit dhe energjisë elektrike, furnizuesit dhe tregtarët, konsumatorë fundorë, përdoruesit e rrjetit, shkëmbimet e gazit dhe OJQ-të e klimës dhe energjisë që përfaqësojnë shoqërinë civile.